



KREDIA ONEFOR NOW: KUSHTET DHE RREGULLAT E PËRGJITHSHME

Kushtet dhe Rregullat e Përgjithshme – Produkti kreditor “OneFor Now”

Këto Kushte dhe Rregulla të Përgjithshme janë në dispozicion në gjuhën shqipe dhe angleze. Ju mund të merrni një kopje në gjuhën e juaj të preferuar duke vizituar faqen tonë www.onefor.com/ks, ose duke i shkarkuar nga aplikacioni OneFor Kosova.

Këto Kushte dhe Rregulla të Përgjithshme zbatohen për të gjithë personat me cilët OneFor Kosova hyn në marrëdhënie kontraktuale për produktin kreditor “OneFor Now”.

1. HYRJE

- 1.1. Këto Kushte dhe Rregulla të Përgjithshme janë përgatitur në harmoni me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe vlejnë për të gjithë marrëdhënien kontraktuale që ju do të lidhni me OneFor Kosova për produktin kreditor “OneFor Now”.
- 1.2. Ky dokument “Kushtet dhe Rregullat e Përgjithshme” përmban dispozitat e përgjithshme që rregullojnë marrëdhënien e kredisë ndërmjet OneFor Kosova dhe kredimarrësit. Ky dokument plotëson dhe duhet të lexohet në lidhje me dokumentet specifike të kredisë, përfshirë: Marrëveshjen e Kredisë, Planin e Pagesave si dhe Marrëveshjen e Pengut.

Përderisa OneFor Kosova pajtohet që t’i japë Kredi sipas kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Kredisë në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshje.

2. DEFINICIONET DHE PËRKUFIZIMET

Klient	Nënkupton personin fizik apo juridik i cili ka të hapur llogari në OneFor i cili pranon dhe përdorë shërbimet të cilat i ofron OneFor Kosovo LLC.
Para Elektronike	Vlera monetare e ruajtur në formë elektronike, duke përfshirë edhe formën magnetike, siç paraqitet nga kërkesa ndaj emetuesit, që emetohet pas pranimi të fondeve me qëllim të kryerjes së transaksioneve të pagesave dhe e cila pranohet si mjet i pagesës nga personat tjerë përveç emetuesit të parasë elektronike.
Aplikacioni	Softueri i zhvilluar nga OneFor i quajtur OneFor APP, me të cilin Klienti mund t’i përdorë shërbimet e ofruara dhe që përmbushë të gjitha kriteret e sigurisë dhe nevojat e Klientit.
OFN	I referohet produktit të kredisë “OneFor Now” të ofruar nga OneFor Kosova për t’i mundësuar Klientit të paguajë për mallrat ose shërbimet në këste gjatë një periudhe të caktuar, jo më gjatë se 12 muaj.
Kryegjësja (Principali)	I referohet shumës fillestare të kredisë të mar nga klienti në institucionin financiar në këtë rast OneFor Kosova, e cila përbën bazën e kredisë dhe për të cilën llogariten interesat dhe pagesat e tjera të lidhura.
Shuma e Blerjes	Kostoja totale e mallrave ose shërbimeve të blera, përfshirë taksat dhe çdo tarifë shtesë të zbatueshme.

Kushtet dhe Rregullat e Përgjithshme – Produkti kreditor “OneFor Now”

Norma e interesit	Norma interesit është kostoja e kredisë e cila përcaktohet në Marrëveshjen e Kredisë. Norma e interesit është e llogaritur në bazë vjetore për 365/366 ditë dhe llogaritet në borxhin e mbetur gjatë tërë kohës së planit të amortizimit të kredisë.
Norma efektive e interesit (NEI)	Është kostoja totale e kredisë së Kredimarrësit, e shprehur si përcindje vjetore e shumës totale të kredisë.
Shpenzime administrative	Janë shpenzimet e përcaktuara në Marrëveshjen e Kredisë për mbulimin e shpenzimeve të administrimit të kredisë.
Këstet	Pagesat periodike që Klienti është i detyruar t'i bëjë sipas kësaj Marrëveshje.
Data e Pagesës	Data e caktuar në të cilën çdo këst duhet të paguhet nga Klienti.
Tarifë	Pagesa ndaj OneFor Kosova në emër të shërbimeve të pranuar nga OneFor Kosova.
Balanca e Pa-paguar	Shuma e mbetur e papaguar e Shumës së Blerjes.
Tarifa e Pagesës me vonesë	Një tarifë që ngarkohet ndaj Klientit për mosbërjen e një pagese brenda afatit.
Marrësi	Person fizik, juridik, organizatë apo entitet tjetër i cili është specifikuar nga Klienti në urdhërin e pagesës si marrës i mjeteve të specifikuara në udhërin e pagesës.
Urdhër pagesa	Urdhër nga paguesi, klienti ose marrësi tek OneFor Kosova për të ekzekutuar një transaksion pagese.
Konfirmimi i pagesës	Pas plotësimit të Urdhërpagesës përmes së cilit finalizohet transaksioni dhe i cili më pas ekzekutohet.
Debitim	Zvoglimi i mjeteve financiare në llogarinë e Klientit pas një transaksioni të kryer nga Klienti në dobi të një pale tjetër.
Kreditim	Çdo transaksion hyrës në llogarinë e Klientit i cili ndikon në rritjen e mjeteve financiare të Klientit.
Transfer	Transferimi i mjeteve nga llogaria e Klientit në OneFor Kosova, në llogarinë e një personi fizik apo juridik, brenda OneFor Kosova.
Nënshkrimi Elektronik	Nënshkrimi i cili pranohet dhe aplikohet në të gjitha dokumentet e lëshuara gjatë pranimit të shërbimeve nga OneFor Kosova, i barazvlefshëm me llojet tjera të nënshkrimit
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
Historia Kreditore	Historia kreditore e klientit merret në mënyrë automatike nga sistemi i BQK-së (Regjistri i Kredive). Klienti i jep pëlqimin OneFor Kosovës që të rishikojë këtë raport për aq kohë sa kredia mbetet aktive, duke filluar nga momenti i aplikimit.
Norma e interesit të kredisë	

Kushtet dhe Rregullat e Përgjithshme – Produkti kreditor “OneFor Now”

Norma e interesit të kredisë është e cekur në kushtet specifike të kredisë. Përcindja e normës së interesit të kredisë do të qëndrojë fikse gjatë gjithë periudhës së kredisë, me kusht që kryegjeja dhe interesi të paguhen sipaj Planit të Pagesave. Norma e interesit është shprehur në bazë vjetore 365/366 ditë në vit, e llogaritur në borxhin e mbetur gjatë tërë kohës së planit të amortizimit të kredisë.

Numri i kësteve është numri i pagesave që huamarrësi duhet të paguaj gjatë kohës së planit të amortizimit të kredisë.

Të gjitha shprehjet dhe përkufizimet tjera të përdorura këtu kanë kuptimin e njëjtë sikurse në “Kushtet dhe Rregullat e Përgjithshme për Përdorimin e Shërbimeve OneFor”.

3. PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

"OneFor Now" (OFN) është produkt kreditor që ofrohet nga OneFor Kosova dhe ju mundëson klientëve që të kompletojnë pagesën e tyre përmes financimit afatshkurtër me këste.

Ky produkt ofrohet me një periudhë prej:

- 3 (tre) muaj pa interes
- 4 (katër) deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj me normë interesi të përcaktuar në Marrëveshjen e Kredisë dhe në Çmimoren e OneFor Kosova

OFN ofrohet tek të gjithë tregtarët që ofrojnë shërbimin e pagesës me këste nga OneFor Kosova.

4. KUSHTET E BLERJES DHE PAGESËS

4.1 Klienti pranon të përdorë shërbimin OFN për të blerë mallra ose shërbime. Shuma minimale për një blerje është 200 (dyqindë) Euro kurse shuma e maksimale e një blerje është 2,000 (dymijë) Euro përfshirë taksat e zbatueshme.

4.2 Maturiteti minimal që ofrohet është tre (3) muaj kurse ai maksimal është dymbëdhjetë (12) muaj.

4.3 Nuk do të ngarkohet asnjë interes mbi shumën e Blerjes, përderisa të gjitha pagesat bëhen brenda afateve të përcaktuara. Në raste të shfrytëzimit të maturitetit minimal prej tre (3), do të aplikohet zero (0) % interes për klientin.

4.4 Në rast të shfrytëzimit të maturitetit nga katër (4) deri në 12 muaj do të aplikohen normat standarde të interesit që janë të përcaktuara. Në raste të caktuara, sipas cmimores se OneFor Kosova, klienti mund të obligohet të paguajë një tarifë për shpenzime administrative që definohet në Marrëveshjen e Kredisë.

4.5 Klienti do të paguajë shumën e Blerjes në këste të barabarta. Kësti i parë është i pagueshëm në datën e realizimit të blerjes, ndërsa këstet e tjera janë të pagueshme nga data e njëjte nga muaji i pagesës se bere dhe vazhdon ne çdo muajt tjetër deri sa të përmbushet në tërësi obligimi i klientit.

4.6 Çdo pagesë e mëpasshme e Kësteve ndjek ciklin e faturimit të përcaktuar për Këstet.

4.7. Klienti, me aplikimin për produkt, lejon që OneFor Kosova të shikojë dhe monitorojë raportin e Regjistrit të Kredive si kusht bazë për aprovimin e produktit. Gjithashtu, klienti autorizon OneFor Kosovën që të rishikojë raportin kreditor për aq kohë sa kredia mbetet active.

4.8 Ne mund të mos ju dërgojmë gjithmonë njoftime ose kujtesa për datat e ardhshme të pagesës së Kësteve. Të dhënat për pagesën e Kësteve janë të disponueshme në llogarinë e juaj në OneFor Kosova.

Ne gjithashtu rezervojmë të drejtën për të refuzuar shërbimet për ju në rast se keni një histori të keqe krediti. Për më tepër, ju pranon se në rastin e një pagese të vonuar, kjo do të reflektohet në historinë tuaj të kreditit me Bankën Qendrore të Kosovës.

4.9 Nëse ndonjë ngarkesë automatike e një Kësti ose e Shumës Totale dështon, ju jeni të detyruar të bëni pagesën e nevojshme menjëherë.

4.10 Për marrjen e produktit kreditor “OneFor Now”, klientët nuk obligohen të ofrojnë kolateral apo të përfshijnë bashkëhuamarrës ose garantues.

4.11 Ne mund t’ju ofrojmë, sipas diskrecionit tonë, oferta dhe përfitime të tilla si zbritje, ngjarje speciale, akses të parakohshëm në produkte, promovime shitjesh, oferta nga tregtarët dhe dhurata. Çdo ofertë ose përfitim i tillë do të jetë nën subjektin e kushteve dhe rregullave të veçanta siç ju do të njoftoheni.

5. NORMA EFEKTIVE E INTERESIT (NEI)

Norma efektive e interesit është kostoja totale e kredisë së Kredimarrësit, e shprehur si përcindje vjetore e shumës totale të kredisë.

Formula e llogaritjes së normës efektive të interesit

$$\sum_{k=1}^m C_k (1+X)^{-t_k} = \sum_{l=1}^{m'} D_l (1+X)^{-S_l}$$

- X është Norma efektive e interesit.

- m është numri total i kësteve të kredisë

- k është numri i kësteve të kredisë së shfrytëzuar

- C_k është shuma e tërheqjes, vlera faktike e kredisë së vënë në dispozicion për klientin në periudhën k,

- tk është intervali i shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së tërheqjes së parë (këstit të parë të kredisë) të vënë në dispozicion për klientin (nëse shfrytëzimi i kredisë bëhet me këste) dhe datës së secilës tërheqje pasuese (çdo kësti pasues) të kredisë së vënë në dispozicion të klientit, prandaj $t_1 = 0$,
- m' është numri total i kësteve të paguara nga klienti për shlyerjen e kredisë dhe/ose pagesave të shpenzimeve/tarifave;
- l është numri në vazhdimësi i kësteve të paguara nga klienti për shlyerjen e kredisë apo pagesave të shpenzimeve/tarifave,
- D1 është shuma e këstit të shlyerjes apo pagesës së shpenzimeve/tarifave, nga klienti në periudhën l.
- S1 është intervali, i shprehur në vite apo fraksione të një viti, ndërmjet datës së vlerës së këstit të parë të kredisë së vënë në dispozicion të klientit (nëse shfrytëzimi i kredisë bëhet me këste) ose datës së shfrytëzimi të kredisë, në rast se shfrytëzimi i kredisë bëhet i plotë dhe datës së secilit këst për shlyerjen e kredisë dhe/ose pagimi i shpenzimeve / tarifave vijuese që paguan klienti.

Llogaritja e NEI bëhet në supozimin se norma vjetore e interesit të kredisë e aplikuar në datën e disbursimit të saj është e njejtë deri në fund të afatit të kredisë si dhe marrëveshja të mbetet e vlefshme për tërë periudhën e rënë dakord. Poashtu llogaritet me supozimin se OneFor Kosova dhe kredimarrësi do të përmbushin detyrimet e tyre sipas kushteve dhe afateve të definuara në këtë Marrëveshje.

Në rast se kredia nuk është disbursuar në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes atëherë, NEI e shprehur si përcindje vjetore mund të dalloj me NEI te prezantuar në planin e pagesave të gjeneruar në datën e disbursimit të kredisë. NEI e prezantuar në Planin e Pagesave të gjeneruar në datën e e disbursimit të kredisë është finale.

Në rast të mospërmbushjes së kushteve bazë të përcaktuara nga OneFor Kosova, si kalimi i pagës përmes OneFor Kosova atëherë, pasi që OneFor Kosova ka dhënë norma interesi preferenciale duke llogaritur një gjë të tillë atëherë, OneFor Kosova ka të drejtën me një paralajmërim prej një muaji të ndryshoj normën e interesit sipas asaj që ofrohet në Cmimoren e OneFor Kosova për raste të tilla.

5. Afatet dhe Kushtet e Kthimit të Kredisë

Kredimarrësi do të kthejë shumën totale të kredisë brenda datave të afatit të cekur në Kontratën për Kredinë. Interesi dhe principali (kryegjësja) do të paguhet nga kredimarrësi sipas Planit të Pagesave, pjesë e kësaj Marrëveshje.

Me kërkesë të klientit, në raste të caktuara kur klienti dëshmon që i ka ndryshuar data kur pranon të hyrat në llogarinë e tij/saj, OneFor Kosova mund të pranoj që të shtyhet data e pagesës së kështit të kredisë. Mirëpo, kjo nuk do të bëhet më gjatë se 30 ditë nga data e pagesës së kështit. Në këtë rast OneFor Kosova do të aplikojë interes sipas Kontratës për Kredinë, që do të llogaritet për ditët sa është shtyrë pagesa e kështit të kredisë.

Pagesa e kështit të kredisë do të konsiderohet e realizuar atëherë kur nga llogaria e klientit në OneFor Kosova janë tërhequr mjetet për pagesën e kështit të kredisë.

6. MOSPAGESAT DHE SHKELJET

6.1 Ndodhja e ndonjë ngjarjeje të mëposhtme do të përbëjë një ngjarje mos pagese sipas kësaj Marrëveshjeje:

6.1.1 Mos pagesa e kështit në datën e Pagesës dhe kjo mos pagesë vazhdon për [1] ditë.

6.1.2 Klienti bën ndonjë shtrembërim në lidhje me këtë Marrëveshje ose bëhet jo-solvent.

6.1.3 Klienti shkel ndonjë kusht tjetër të rëndësishëm të kësaj Kontrate.

6.2 OneFor Kosova do të aplikojë kamatëvonesë duke filluar nga dita e parë e vonesës nga kredimarrësit. OneFor Kosova do të aplikojë normën e kamatëvonesës bazuar në Rregulloren për Kamatëvonesën e Instrumenteve Kreditore të BQK-së. Llogaritja e normës së kamatëvonesës do të jetë norma vjetore, e cila përbëhet nga norma referente e rritur për 8 (tetë) përcind normë fikse. BQK publikon në bazë të rregullt gjashtë mujore të dhëna për normën referente si pjesë e kamatëvonesës. Në rastet kur BQK nuk e ka publikuar normën referente në fuqi, duhet përdorur norma referente e BQK-së e publikuar së fundi.

6.3 Metoda e llogaritjes së kamatëvonesës është e percaktuar në Rregulloren për Kamatëvonesën e Instrumenteve Kreditore të BQK-së, si në vijim:

6.4 Kamatëvonesa do të përlllogaritet për shumën e kryegjësë në vonesë përgjatë numrit të ditëve kalendarike në vonesë varësisht nga numri i ditëve kalendarike të vitit (365 ose 366), duke aplikuar formulën matematikore si më poshtë:

$$KV = \frac{B * Nv * D}{Nd}$$

ku:

KV – kamatëvonesa për periudhën kontabël;

B –Borxhi kryesor (kryegjëja) në vonesë;

Nv – Norma vjetore e kamatëvonesës;

D – Numri i ditëve kalendarike të kamatëvonesës gjatë periudhës kontabël;

Nd – Numri i ditëve kalendarike të vitit (365 ditë – viti i zakonshëm, 366 ditë – viti i brishtë).

Kamatëvonesa e llogaritur për secilën periudhë kontabël (zakonisht mujore) i shtohet kamatëvonesës së përlllogaritur, kështu që, kamatëvonesa e përlllogaritur është shuma totale 4 prej 4 e të gjitha kamatëvonesave të llogaritura për të gjitha pagesat në vonesë të kryegjësë deri me ditën e llogaritjes.

6.5 Pas ndodhjes së ndonjë Mos pagese, OneFor Kosova mund, sipas diskrecionit të saj të plotë:

6.5.1 Të ndërpresë Kontratën dhe të kërkojë pagesën e menjëhershme të gjithë Bilancit të Pashlyer.

6.5.2 Të përdorë të gjitha mjetet ligjore në dispozicion për të rikuperuar çdo shumë të borxhit.

7. Parapagimi i Kredisë

7.1 Nëse kredimarrësi dëshiron të shlyej tërësisht kredinë para datës së përfundimit të afatit të kredisë atëherë, kredimarrësi detyrohet t’ia paguaj OneFor Kosova kompensimin për parapagim të kredisë prej 0.5% të shumës së kredisë së paguar para afatit.

7.2 OneFor Kosova do ti përfundojë të gjitha procedurat e mbylljes së kredisë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pas pranimit të kërkesës për parapagim të kredisë nga kredimarrësi.

7.3 Në raste të parapagimit të pjesshëm të kredisë, kredimarrësi do të nënshkruaj Planin e ri të Pagesave. Në rastin e parapagimit të pjesshëm, OneFor Kosova do të aplikojë tarifë 1% të shumës së paguar para afatit.

8. ANKESAT

8.1. Nëse Ju keni nevojë për informata shtesë apo nuk jeni të kënaqur me ndonjë element të shërbimit që pranoni, atëherë Ju mund të paraqisni ankesën tuaj përmes kanaleve në dispozicion, siç është e-mail adresa zyrtare, qendrën e thirrjeve të kujdesit për klient apo përmes aplikacionit OneFor Kosova. Ne do t’i përgjigjemi ankesës tuaj, në e-mail-in tuaj të regjistruar. Një përgjigje e tillë adreson të gjitha pikat e ngritura, brenda një afati të duhur kohor dhe më së voni brenda tri (3) ditëve të punës nga pranimi i ankesës. Në situata të jashtëzakonshme, nëse përgjigja nuk mund të jepet brenda tri (3) ditëve të punës për arsye përtej kontrollit tonë, Ne do t’ju mbajmë Ju të

Kushtet dhe Rregullat e Përgjithshme – Produkti kreditor “OneFor Now”

informuar duke treguar qartë arsyet e një vonese në përgjigjen e ankesës, dhe duke specifikuar afatin deri në të cilin do të merrni përgjigjen përfundimtare.

8.2. Në rast se Ju nuk jeni të kënaqur me përgjigjen tonë, Ju keni të drejtë t’i drejtoheni Bankës Qendrore të Kosovës si në vijim:

- a) T’i adresoheni përmes postës në adresën: Rr. Garibaldi nr 33 Prishtinë, Kosovë;
- b) T’i drejtoheni me ankesë në linkun: <https://bqk-kos.org/ankesat/>;
- c) T’i telefononi në numrin: 038 222 055.

8.3. Në rast të dështimit për të zgjidhur një mosmarrëveshje në mënyrë miqësore ose me metoda të tjera jashtëgjyqësore të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, mosmarrëveshja do të zgjidhet nga gjykata kompetente sipas ligjit të zbatueshëm.

8.4 Çdo ankesë në lidhje me Produktet apo Shërbimet që blini përmes OFN do të trajtohet ekskluzivisht nga Tregtari dhe me këtë, ju pranoni se OneFor Kosova nuk ka asnjë përgjegjësi ose detyrë ndaj jush në lidhje me çdo çështje të performancës, tregtueshmërisë ose përshtatshmërisë së vet mallrave apo shërbimeve.

8.5 Nëse produktet kthehen te Tregtari brenda 5 ditëve nga data e blerjes, Klienti nuk detyrohet të paguajë interesin e akumuluar. Pas ditës së 5-të, interesi i akumuluar nuk mund të fshihet ose anulohet.

8.6 Pasi të marrim një konfirmim me shkrim nga një Tregtar për të rikthyer një shumë që është pagueshme për një Produkt apo Shërbim, ne do të kreditojmë llogarinë tuaj në OneFor Kosova me bilancin përkatës.

8.7 Nën asnjë rrethanë ne nuk do të jemi të detyruar të paguajmë ndonjë shumë direkt ndaj jush që do të kreditohet në llogarinë tuaj të OneFor Kosova si pjesë e një rimbursimi.

9. MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE RIKTHIMI I TË DHËNAVE

9.1. Me hyrjen në këtë Marrëveshje, Ju na ofroni Ne dhe Lëshuesit pëlqimin tuaj paraprak të shprehur për të mbledhur, përdorur dhe përpunuar informatat tuaja personale dhe zbulimin e informatave për palët e treta, për të përmbushur detyrimet e saj sipas marrëveshjes dhe siç përcaktohet në politikën e privatësisë në përputhje me Ligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

9.2. Me nënshkrimin e marrëveshjes për produktin kreditor “OneFor Now” të OneFor Kosova, Ju pranoni t’i jepni Lëshuesit, përpunuesit dhe bashkëpunëtorëve të tyre të drejtën për të mbledhur informacione rreth juve, për qëllimet e administrimit të shërbimit të kartelës, përpunimin e transaksioneve të kryera duke përdorur shërbimin, mirëmbajtjen e rregullt të llogarisë dhe qëllime të tjera siç përcaktohet në politikën e privatësisë.

9.3. Ndërsa Ne, rezervojmë të drejtën për të përpunuar dhe ruajtur të dhëna në vendet jashtë Bashkimit Evropian, Ne do ta bëjmë këtë vetëm në pajtueshmëri të plotë me Ligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

9.4 Ne marrim përsipër të kemi masat e duhura për të mbrojtur të dhënat tuaja dhe të sigurojmë se Ne do të përpunojmë të dhënat personale të përdoruesve tonë vetëm nëse Ne kemi leje ligjore, apo nëse Ju keni dhënë pëlqimin tuaj. Ju do të gjeni detaje rreth mënyrës se si Ne i trajtojmë të dhënat personale, mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e të dhënave në politikën tonë të privatësisë në këtë link.

9.5. Të dhënat transmetohen përmes një lidhje të sigurt dhe të koduar në Internet.

9.6. Ju mund t’i rishikoni të dhënat tuaja në OneFor App në çdo kohë. Ju gjithashtu keni të drejtë të kërkonte dhe të merrni informata në çdo kohë në lidhje me ndonjë nga të dhënat tuaja që mund të ruhen, burimin e tyre, pranuesit e të dhënave të tilla dhe pse po ruhen.

9.7. Ne kemi të drejtë të regjistrojmë dhe mbajmë të gjitha të dhënat tuaja dhe komunikimin me Ju, pa njoftim paraprak dhe do të zgjedhim në mënyrë të njëanshme mjetet teknike për regjistrimin e të njëjtave. Ne do të regjistrojmë dhe mbajmë të gjitha të dhënat në pajtim me kërkesat e akteve ligjore të zbatueshme dhe politikën e mbrojtjes së të dhënave. Ju do të pajtoheni që Ne kemi të drejtë t’i përdorim këto të dhëna si dëshmi për mbrojtjen e interesave tona në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe në gjykatë.

9.8. Në rast se një autoritet shtetëror, sikurse organet e ndjekjes, gjykatat, autoriteti përkatës tatimor apo rregullatorët kërkojnë informata në lidhje me llogarinë tuaj, Ne jemi të detyruar të zbulojmë informatat për Ju dhe llogarinë (të) tuaj(a) me autoritetin përkatës pa pasur nevojë për ndonjë pëlqim të tillë nga ana juaj, bazuar në nenin 22 të Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nëse një autoritet i tillë kërkon më shumë informata, Ne do t’ju qasemi Ju, dhe presim që Ju të jepni informatat e kërkuara menjëherë. Nëse Ju nuk e bëni këtë, Ju pranoni që Ne mund të pezullojmë ose mbyllim llogarinë tuaj, ose, nëse ligji ose rregullorja na kërkon Ne që ta bëjmë këtë, që Ne mund të mbajmë pjesë të disa pagesave të pranuar në llogarinë tuaj dhe të kalojmë fondet e mbajtura autoriteteve përkatëse tatimore.

9.9. Ne do të mbajmë të dhënat tuaja të ruajtura pasi që kjo marrëveshje të jetë ndërprerë në pajtim me kërkesat ligjore.

9.10. OneFor App mund të merret nga platformat e shitjeve të cilat operohen nga palë të treta (“dyqanet online të aplikacioneve”). OneFor App mund të merret vetëm nëse Ju jeni regjistruar së pari në dyqanin përkatës të aplikacioneve. Ne nuk kemi asnjë ndikim në mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave biznesore apo personale nga kompania e palës së tretë e cila operon dyqanin e aplikacioneve që Ju përdorni. Deri më tani, vetëm kjo kompani operuese e palëve të treta është kontrolluesi ekskluziv.

10. KONFIDENCIALITETI

10.1. Klienti dhe OneFor Kosova pajtohen që nuk do të zbulojnë apo të lejojnë me dashje apo nga pakujdesia zbulimin e ndonjë prej kushteve të kësaj Kontrate ndonjë pale të tretë, pa marrë aprovimin me shkrim nga pala tjetër për të zbuluar këto kushte.

10.2. Parimi i konfidencialitetit nuk vlen në rastet kur:

- a) Është e nevojshme përmbushja e detyrimit ligjor
- b) Ka urdhër të lëshuar nga Gjykata për dorëzimin e dokumentacioneve
- c) Paraqitet kërkesë e institucionin kompetent për tatime, vlerësime apo regjistrime të tjera.

10.3. Në rast të shkeljes së Konfidencialitetit nga cilado palë pjesë e kësaj Kontrate, pala që ka bërë shkeljen do të bart të gjitha përgjegjësit dhe dëmet eventuale që mund të jenë shkaktuar palës tjetër.

11. VEPRIMTARITË E NDALUARA

11.1. Në asnjë rrethanë Ju nuk mund të përdorni produktin kreditor “OneFor Now” për aktivitetet si më poshtë:

- Në shkelje të ligjeve apo rregulloreve në zbatim, duke përfshirë ato që rregullojnë shërbimet financiare;
- Në shkelje të kësaj marrëveshjeje dhe shtojcave të saj;
- Në një mënyrë që shkel privatësinë ose të drejtat pronësore, autoriale, sekrete komerciale dhe të drejta të tjera intelektuale të një tjetri, përfshirë spam, phishing ose kërkesa të padëshiruara;
- Për të kryer veprime të paligjshme, duke përfshirë bixhozin e paligjshëm dhe veprimet që përfshijnë mallra të vjedhura ose substanca të paligjshme;
- Për të kryer transaksione që përfshijnë transferimin e fondeve për qëllime të paligjshme ose të bëra për të fshehur burimin e fondeve të tilla (“pastrimi i parave”).
- Duke dhënë informacion të rremë ose të pasaktë për OneFor apo duke refuzuar për të dhënë informacionet e sakta ose të ndërmarrë veprime të tjera që kërkohen nga OneFor;
- Për të përdorur shërbimet e OneFor në një mënyrë që shkakton humbje ose pasojat tjera negative ligjore ose financiare ose dëmtuar reputacionin e OneFor ose personave të tretë;
- Përdor shërbimet e OneFor, nëse Klienti, përfaqësuesi i tyre, pronari i përfituar, ose transaksioni i Kryer ose pranuar përputhet me kriteret e përcaktuara në listën e kufizimeve për ofrimin e shërbimeve të OneFor

Klienti nuk ka të drejtë që mënyrë të njëanshme të ndryshojë ndonjë nga kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

12. SHPENZIMET

12.1. Tarifat për përdorimin e shërbimeve të OneFor Kosova përfshirë produktin kreditor “OneFor Now”, përfshirë shumën e pagesave, që tejkalojnë tarifin e pajtuara për shërbimin kryesor, janë të detajuara në ”Listën e çmimeve dhe shërbimeve” në dispozicion në faqen e internetit të OneFor (www.onefor.com). Përveç nëse Ne jemi pajtuar ndryshe, tarifin e deklaruar në ”Listën e çmimeve dhe shërbimeve” zbatohen për të gjitha shërbimet kryesore të renditura.

12.2. Shumat e deklaruara në “Listën e çmimeve dhe shërbimeve” përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar.

12.3. Ne do të kemi të drejtë të ndryshojmë në mënyrë të njëanshme “Listën e çmimeve dhe shërbimeve”, duke dhënë një njoftim mbi ndryshimet e tilla tridhjetë (30) ditë më herët se “Lista e re e çmimeve dhe shërbimeve” të bëhet efektive.

13. AFATI DHE NDËRPRERJA

13.1. Kontrata për përdorimin e produktit kreditor “OneFor Now” bëhet efektive në datën e arritjes së Marrëveshjes mes nesh dhe lidhet për një periudhë të pakufizuar.

13.2. Ne mund të dërgojmë njoftim me shkrim ose e-mail tridhjetë (30) ditë përpara për të ndërprerë kontratën e përdorimit me Ju. OneFor Kosova rezervon të drejtën për ta ndërprerë Kontratën në mënyrë të njëanshme në rast se përdorimi i llogarisë bie ndesh me politikën dhe procedurat e brendshme të kompanisë.

13.3. Kontrata po ashtu mund të ndërpritet pa njoftim nga secila palë për një shkak të mirë. Një shkak i mirë që do të na lejojë Ne të ndërpresim pa njoftim do të ishte nëse do të ishte e paarsyeshme të presim që kjo kontratë të vazhdojë edhe sa i përket interesave tuaja legjitime. Një shkak i mirë do të përfshinte gjithashtu, por nuk do të kufizohej në një shkelje të detyrimit të përshkruar ndërmjet Ju dhe Lëshuesit.

13.4. Ne dhe Ju nuk do të mbajnë përgjegjësi për mos përmbushjen ose përmbushjen e pamjaftueshme të detyrimeve, ose për çdo mospërputhje me Marrëveshjen, nëse një mos përmbushje e tillë ose e papërshtatshme është shkaktuar nga forca madhore (p.sh. katastrofat natyrore, lufta, bllokada e kushteve luftarake, embargot, trazirat, kufizimet qeveritare, trazirat e punës, rrënojat, epidemitë, karantina, zjarri, përmytja, tërmeti, shpërthimi, çdo ndryshim i paparashikuar i rrethanave ose çdo shkak tjetër jashtë kontrollit të arsyeshëm të tij);

13.5. Ju do të na njoftoni Ne për forcën madhore me e-mail ose me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike pas ditës së shfaqjes së rrethanave të tilla.

13.6. Ne do të ju njoftojmë Ju për rrethanat e forcës madhore në njërën nga metodat e komunikimit për të cilat jemi pajtuar t’i përdorim së bashku.

14. NDRYSHIMET NË KUSHTET DHE RREGULLAT E BIZNESIT

14.1 Ne do të kemi të drejtë që t’i ndryshojmë kushtet dhe rregullat e biznesit tonë në çdo kohë. Ne do t’ju ofrojmë Ju çdo ndryshim të kushteve dhe rregullave të biznesit me e-mail brenda tridhjetë (30) ditëve më së voni nga koha e propozuar në të cilën ndryshimet do të hyjnë në fuqi. Ju ose mund të pajtoheni ose t’i refuzoni ndryshimet në kushte dhe rregullat e biznesit para datës në të cilën është propozuar që ndryshime të tilla të hyjnë në fuqi. Në rast se refuzoni ndryshimet në kushtet dhe rregullat e përgjithshme, atëherë Ju mund të ndaloni së përdoruri shërbimet tona. Do të konsiderohet se Ju keni dhënë pëlqimin nëse Ju nuk njoftoni refuzimin tuaj para datës në të

cilën është propozuar që ndryshime të tilla të hyjnë në fuqi. Ne do t’i bëjmë referencë të veçantë rëndësisë së pëlqimit tuaj në ofertën tonë.

15. LIGJI QEVERISËS DHE DISPOZITAT PËRUNDIMTARE

15.1. Palët konfirmojnë se i plotësojnë të gjitha kërkesat e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për ekzekutimin e kësaj Marrëveshje.

15.2. Titujt e neneve të kësaj Marrëveshje kanë për qëllim vetëm lehtësimin e kuptimit të Marrëveshjes nga ana e palëve dhe nuk mund të përdoren për interpretimin e saj.

15.3. Kushtet e kësaj marrëveshjeje do të rregullohen dhe interpretohen në pajtim me ligjet e Republikës së Kosovës dhe gjykatat e Kosovës do të merren me çdo procedurë ligjore ndërmjet nesh. Palët kanë përgjegjësi të pavarur ndaj shtetit dhe subjekteve të tjera për përmbushjen e të gjitha detyrimeve tatimore.

15.4. Klienti nuk ka të drejtë të transferojë të drejtat dhe detyrimet e tyre që dalin nga kjo Marrëveshje te palë të treta pa një miratim të paraprak të shkruar nga OneFor Kosova. OneFor Kosova rezervon të drejtën për të transferuar të drejtat dhe detyrimet e saj që dalin nga kjo Marrëveshje te palë të treta në çdo kohë pa miratimin e Klientit, nëse një transferim i këtyre të drejtave dhe detyrimeve nuk i kundërvihet ligjit.

15.5. Kjo marrëveshje përbën të gjithë marrëveshjen midis Ju dhe Ne në lidhje me shërbimet e OneFor Kosova – “OneFor Now”. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj marrëveshje përcaktohet të jetë e pazbatueshme sipas ligjit në fuqi, dispozitat e tjera të kësaj marrëveshjeje do të mbesin të vlefshme dhe të zbatueshme. Një dështim nga Ne për të zbatuar kryerjen e ndonjë dispozite të kësaj marrëveshjeje nuk do të përbëjë në asnjë mënyrë heqje dorë nga Ne nga e drejta jonë për të zbatuar më pas një dispozitë të tillë ose ndonjë dispozitë tjetër të kësaj marrëveshjeje. Ato dispozita të kësaj marrëveshjeje që synojnë t’i mbijetojnë çdo ndërprerje ose anulim të kësaj Marrëveshjeje do të mbesin në fuqi pas ndonjë ndërprerje ose anulimi të tillë.